

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin e Almerias, në Spanjë, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin e Almerias në kuadër të programit Erasmus +, për studentët e Universitetit të Tiranës për studime, për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Bachelor (studentë të vitit të dytë);

Kohëzgjatja e bursave:

-Bachelor (5 muaj);

Fushat e studimit:

- Ekonomiks;
- Kontabilitet;
- Financë;
- Manaxhim dhe Administrim;
- Marketing;
- Gjuhë angleze;
- Gjuhë spanjolle.

Për më shumë informacion mbi Universitetin e Almerias ju lutem referohuni linkut:

<https://www.ual.es/>

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Almerias në gjuhën angleze klikoni në adresën:

<http://cms.ual.es/UAL/en/estudios/grados/index.htm>

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës);

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Procedura e aplikimit dhe dokumentat e nevojshme për aplikim:

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët **Bachelor**:

- CV (në gjuhën angleze/spanjolle);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit i nivelit Bachelor (i përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze/spanjolle);
- Listë notash (i përkthyer zyrtarisht në gjuhën angleze spanjolle);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze/spanjolle);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (gjuhës angleze apo spanjolle) e nivelit B1;

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë 'Before the Mobility'. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Almerias lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek seksioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: 3 Maj 2019

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!